



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE NË
EMIRATET E BASHKUARA ARABE**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e arsimit dhe shkencës, Instituti MASDAR me qendër në Emiratet e Bashkuara Arabe, i njohur në fushën e energjive të rinovueshme, ofron 10 (dhjetë) bursa studimi pasuniversitare në programet master ose doktoraturë për studentë shqiptarë në fushën e energjive të rinovueshme, për vitin akademik 2015-2016.

Kandidatët e interesuar për këto bursa duhet të kenë përfunduar studimet për shkencë ekzakte ose për inxhinieri në programe bachelor ose master pranë universiteteve ose shkollave të larta brenda dhe jashtë vendit.

Kandidatët duhet të kenë përvojë pune, të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe duhet të aplikojnë direkt pranë Institutit MASDAR duke përdorur tre adresa reference e-mail. Preferohet e-mail zyrtar i institucionit nga vjen aplikanti, i cili është edhe parakusht për këtë aplikim. Lista e studentëve shqiptarë të përzgjedhur nga universitetet përkatëse ku bëjnë pjesë këta aplikantë dhe dokumentacioni përkatës, duhet të dërgohet drejtpërdrejtë në zyrën e regjistrimeve të institucionit, në adresën elektronike: salharbi@masdar.ac.ae. Aplikantët mund të jenë, gjithashtu, punonjës të shërbimit civil, por që punojnë në sektorë me perspektivë zhvillimi dhe mund të aplikojnë, gjithashtu, me miratimin e titullarit të institucionit të tyre.

Kandidatët e interesuar për këto bursa duhet të plotësojnë dokumentet në vijim:

1. Formularin e aplikimit online;
2. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe të II të studimeve të larta ose pasuniversitare (format PDF);
3. CV që pasqyron nivelet e arsimit, listën e publikimeve, çmimet e fituara, përvojën profesionale, etj. (format PDF);
4. Kopjen e noterizuar të Suplementit të Diplomës ose listën e leksioneve (përfshirë numrin e orëve) dhe listën e notave (format PDF);
5. Letrën e interesit me objektiva konkretë për programin e studimit Master i Shkencave (format PDF);
6. Një përshkrim të shkurtër deri në dy faqe të programit të studimit, si dhe fushës së kërkimit për aplikantët në doktoraturë (format PDF);
7. Certifikatën e njohjes së gjuhës angleze TOEFL ose IELTS (format PDF);
8. Fotokopjen e faqes së pasaportës (format PDF);
9. Raportin mjekësor për aftësi studimi (format PDF).

Me përfundimin e cikleve akademike studentët e kualifikuar pajisen me një certifikatë nga Instituti "Masdar" dhe nga Instituti i Teknologjisë "Massachusetts".

Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit të ushqimit, shpenzimet për materiale e pajisje (laptop, libra etj.), do të mbulohen nga Instituti MASDAR. Afati i fundit për këtë aplikim deri në dorëzimin e dokumentacionit është data 31 maj 2014.

Për një informacion më të detajuar për programet akademike, kriteret, procedurat, si dhe afatet e aplikimeve, referojuni adresave on-line të Institutit MASDAR në vijim:

www.masdar.ac.ae

<http://www.masdar.ac.ae/admissions/admissions-requirement>

<http://www.masdar.ac.ae/admissions/how-to-apply>

info@masdar.ac.ae

Tel: +971 2 810 9333

Fax: +971 2 810 9901

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE